

K U S H T E T U T A E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social.
Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pakontestueshëm.

Neni 2

Në Republikën e Maqedonisë sovraniteti buron nga shtetasit dhe u takon shtetasve.
Shtetasit e Republikës së Maqedonisë pushtetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë.

Neni 3¹

Territori i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm.
Kufiri ekzistues i Republikës së Maqedonisë është i pacenueshëm.

Kufiri i Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohet vetëm në pajtim me Kushtetutën, e në bazë të parimit të vullnetarizmit dhe në pajtim me normat përgjithësisht të pranuara ndërkombëtare.

Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje.

Neni 4

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë kanë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë.
Shtetasve të Republikës së Maqedonisë nuk mund t'u merret shtetësia, as të dëbohen ose t'i dorëzohen shtetit tjetër.

Shtetësia e Republikës së Maqedonisë rregullohet me ligj.

Neni 5

Simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë janë: stema, flamuri dhe himni.
Stema, flamuri dhe himni i Republikës së Maqedonisë përcaktohen me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Neni 6

Kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë është Shkupi.

Neni 7²

Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik.

Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.

Dokumentet personale të shtetasve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe shkrimin e saj në pajtim me ligjin.

Cilido shtetas i cili jeton në njësinë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e shtetasve flasin gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund të përdor cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi. Çdo shtetas në komunikim me ministrinë mund të përdor një nga gjuhët zyrtare dhe shkrimin e saj, ndërsa ministrinë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe shkrimin të cilin e përdor shtetasi.

¹ Neni 3 i Kushtetutës së RM-së është plotësuar me Amendamentin I, pika 1, ndërsa paragrafi 3 i Nenet 3, është zëvendësuar me Amendamentin I, pika 2.

² Neni 7 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin V, pika 1.

Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në pajtim me ligjin.

Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe shkrimi që e përdorin së paku 20% e shtetasve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe shkrimeve të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njëjste të vetadministrimit lokal.

Neni 8³

Vlera themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë:

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut e të shtetasit të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare, **përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i shtetasve të cilët u takojnë të gjitha komuniteteve në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet;**
- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në atë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e ndërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetadministrimi lokal;
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës dhe
- respektimi i normave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë është e lirë çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj.

II. LIRITË DHE TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT E TË SHTETASIT

1. Liritë dhe të drejtat civile dhe politike

Neni 9

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore.

Shtetasit janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 10

Jeta e njeriut është e pacenueshme.

Në Republikën e Maqedonisë nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje sipas asnjë baze.

Neni 11

Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm.

Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues.

Ndalohet puna me dhunë.

Neni 12⁴

Liria e njeriut është e pacenueshme.

Askujt nuk mund t'i kufizohet liria, përveçse me vendimin e gjykatës dhe në rastet dhe në procedurën e caktuar me ligj.

Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë të njoftohet me shkaqet për thirrjen, arrestimin ose privimin e tij nga liria dhe me të drejtat e tij të caktuara me ligj dhe prej tij nuk mund të kërkohet deklaratë. Personi ka të drejtë në mbrojtës në procedurën policore dhe gjyqësore.

Personi i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të nxirret para gjykatës, e cila pa shtyrje do të vendosë për ligjshmërinë e privimit nga liria.

³ Alinea 2 e paragrafit 1 të Nenit 8 të Kushtetutës së RM-së është plotësuar me Amendamentin VI, pika 1.

⁴ Neni 12, paragrafi 5 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin III, pika 1.

Paraburgimi deri me ngritjen e akuzës, në bazë të vendimit të gjykatës, mund të zgjas më së shumti 180 ditë nga dita e paraburgimit.

Pas ngritjes së akuzës, paraburgimin e vazhdon ose e përcakton gjykata kompetente në rastin dhe në procedurën e caktuar me ligj.

Personi i paraburgosur nën kushtet e caktuara me ligj mund të lëshohet të mbrohet në liri.

Neni 13⁵

Personi i akuzuar për veprë penale do të konsiderohet i pafajshëm për derisa fajësia e tij të vërtetohet me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor.

Personi në mënyrë jo të ligjshme i privuar nga liria, i paraburgosur ose i dënuar në mënyrë jo të ligjshme, ka të drejtën e kompensimit të dëmit dhe të drejta të tjera të caktuara me ligj.

Për kundravajtje të caktuara me ligj, sanksion mund të shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organizata dhe organi tjetër që ushtron autorizime publike.

Kundër vendimit të formës së prerë për kundravajtje garantohet mbrojtja gjyqësore nën kushte dhe në procedurë të rregulluar me ligj.

Neni 14

Askush nuk mund të dënohet për veprë e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e caktuar me ligj ose me dispozitë tjetër si veprë e dënueshme dhe për të cilën nuk ka qenë i parashikuar dënimi.

Askush nuk mund të gjykohet sërish për veprë për të cilën ka qenë i dënuar një herë dhe për të cilën është marrë vendim i plotëfuqishëm gjyqësor.

Neni 15⁶

Garantohet e drejta e ankesës kundër vendimeve të nxjerra në procedurë në shkallë të parë para gjykatës.

E drejta e ankesës ose lloji tjetër i mbrojtjes juridike kundër akteve individuale juridike të nxjerra në procedurë në shkallë të parë para organit të administratës shtetërore ose organizatës dhe organit tjetër që ushtron autorizime publike rregullohet me ligj.

Neni 16

Garantohet e drejta e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit.

Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe e themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.

Garantohet qasja e lirë informatave, liria e pranimit dhe e bartjes së informatave. Garantohet e drejta e përgjegjes në mjetet e informimit publik.

Garantohet e drejta e përmirësimit në mjetet e informimit publik.

Censura është e ndaluar.

Neni 17⁷

Garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit. Vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, nën kushte dhe në procedurë të caktuar me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe formave të tjera të komunikimit, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të pengimit ose zbulimit të veprave penale, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës. Ligji nxirret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Neni 18

Garantohet siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale.

Shtetasve u garantohet mbrojtja nga shkelja e integritetit personal që buron nga regjistrimi i informatave për ta nëpërmjet përpunimit të të dhënave.

Neni 19⁸

Garantohet liria e besimit fetar.

Garantohet shprehja e lirë dhe publike e fesë, individualisht ose në bashkësi me të tjerët.

⁵ Neni 13 i Kushtetutës së RM-së është plotësuar me Amendamentit XX, pika 1.

⁶ Neni 15 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentit XXI, pika 1.

⁷ Neni 17 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XIX, pika 1.

⁸ Neni 19, paragrafi 3 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentit VII, pika 1, ndërsa paragrafi 4 është zëvendësuar me Amendamentin VII, pika 2.

Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Methodiste, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të lira në themelimin e shkollave fetare dhe enteve bamirëse dhe sociale sipas procedurës të parashikuar me ligj.

Neni 20

Shtetasve u garantohet liria e bashkimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera.

Shtetasit mundën lirisht të themelojnë shoqata civile dhe parti politike, të hyjnë në to dhe të dalin nga ato.

Programet dhe veprimtaria e shoqatave civile dhe partive politike nuk mund të orientohen drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës dhe drejt nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak ose nxitjes të urrejtjes ose mosdurimit kombëtar, racor ose fetar.

Janë të ndaluara shoqatat ushtarake ose gjysmë-ushtarake të cilat nuk u takojnë forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë.

Neni 21

Shtetasit kanë të drejtë në mënyrë të qetë të tubohen dhe të shprehin protestë publike pa paraqitje paraprake dhe pa leje të veçantë.

Shrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 22

Çdo shtetas që ka mbushur 18 vjeç e fiton të drejtën e zgjedhjes.

E drejta e zgjedhjes është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë.

Të drejtë zgjedhjeje nuk kanë personat të cilëve u është marrë aftësia për të vepruar.

Neni 23

Çdo shtetas ka të drejtë të merr pjesë në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 24

Çdo shtetas ka të drejtë të paraqesë parashtrësia para organeve shtetërore dhe shërbimeve tjera publike dhe për ato të merr përgjegjeje.

Shtetasi nuk mund të thërritet në përgjegjësi, as të pësojë pasoja të dëmshme për qëndrimet e paraqitura në parashtrësia, përveç nëse me to nuk ka kryer vepër penale.

Neni 25

Çdo shtetasi i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit.

Neni 26

Garantohet paprekshmëria e banesës.

E drejta e paprekshmërisë së banesës mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve.

Neni 27

Çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë që të lëvizë lirisht në territorin e Republikës dhe lirisht të zgjedhë vendbanimin e tij.

Çdo shtetas ka të drejtë të lëshojë territorin e Republikës dhe të kthehet në Republikë.

Realizimi i këtyre të drejtave mund të kufizohet me ligj, vetëm në rastet kur kjo është e nevojshme me qëllim të mbrojtjes të sigurisë së Republikës, zhvillimit të procedurës penale ose mbrojtjes së shëndetit të njerëzve.

Neni 28

Mbrojtja e Republikës së Maqedonisë është e drejtë dhe detyrë e çdo shtetasi.
Realizimi i kësaj të drejte dhe detyre të shtetasve rregullohet me ligj.

Neni 29

Të huajt në Republikën e Maqedonisë i gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, nën kushtet e caktuara me ligj dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Republika ua garanton të drejtën e strehimit të huajve dhe personave pa shtetësi, të përndjekur për shkak të bindjeve dhe veprimeve politike demokratike.

Ekstradimi i të huajit mund të bëhet vetëm në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit. I huaji nuk mund të ekstradohet për shkak të veprës penale politike. Veprimet e terrorizmit nuk konsiderohen vepra penale politike.

2. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Neni 30

Garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë.

Pronësia krijon të drejta dhe detyrime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë.

Askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveçse kur kemi të bëjmë me interesin publik të caktuar me ligj.

Në rast të eksproprijimit të pronësisë ose në rast të kufizimit të pronësisë garantohet kompensimi i drejtë i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut.

Neni 31

Personi i huaj në Republikën e Maqedonisë mund të fitojë të drejtën e pronësisë nën kushtet e caktuara me ligj.

Neni 32

Secili ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punës, mbrojtje gjatë punës dhe në sigurim material gjatë kohës të papunësisë së përkohshme.

Secilit, nën kushte të barabarta, i është i arritshëm çdo vend pune.

Secili i punësuar ka të drejtë në pagë adekuate.

Secili i punësuar ka të drejtë në pushim të paguar ditor, javor dhe vjetor. Të punësuarit nuk mund të heqin dorë nga këto të drejta.

Realizimi i të drejtave të të punësuarëve dhe pozita e tyre rregullohen me ligj dhe me kontrata kolektive.

Neni 33

Secili është i obliguar të paguaj tatim dhe detyrime të tjera publike dhe të merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve publike në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 34

Shtetasit kanë të drejtë në siguri sociale dhe sigurim social të caktuar me ligj dhe me kontratë kolektive.

Neni 35

Republika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale të shtetasve në pajtim me parimin e drejtësisë sociale.

Republika ua garanton të drejtën e ndihmës shtetasve të pafuqishëm dhe të paaftë për punë.

Republika u siguron mbrojtje të veçantë invalidëve dhe kushte për inkuadrimin e tyre në jetën shoqërore.

Neni 36

Republika u garanton të drejta të veçanta sociale luftëtarëve të Luftës Antifashiste dhe të gjitha luftërave nacional-çlirimtare të Maqedonisë, invalidëve të luftës, të përndjekurëve dhe të burgosurëve për idetë e vetëqenies së popullit maqedonas dhe të shtetshmërisë së tij, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilët nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe sociale.

Të drejtat e veçanta rregullohen me ligj.

Neni 37

Me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale, shtetasit kanë të drejtë të themelojnë sindikata. Sindikatat mund të themelojnë bashkimet e tyre dhe të anëtarësohen në organizatat sindikale ndërkombëtare.

Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së organizimit sindikal në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës.

Neni 38

Garantohet e drejta e grevës.

Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së grevës në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës.

Neni 39

Secili i garantohet e drejta e mbrojtjes shëndetësore.

Shtetasi ka të drejtë dhe detyrë që të ruajë dhe të përparojë shëndetin e tij dhe shëndetin e të tjerëve.

Neni 40

Republika kujdeset dhe i siguron mbrojtje të veçantë familjes.

Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj.

Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve.

Fëmijët janë të obliguar që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pafuqishëm.

Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prind dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.

Neni 41

Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendos për lindjen e fëmijëve.

Republika, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe social harmonik, udhëheq një politikë humane të popullimit.

Neni 42

Republika veçanërisht e mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur.

Personi më i ri se 15 vjeç nuk mund të punësohet.

Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në punë.

Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.

Neni 43

Secili ka të drejtë për mjedis të shëndosh jetësor.

Secili është i obliguar ta përparojë dhe ta mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën.

Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së shtetasve për mjedis të shëndoshë jetësor.

Neni 44

Secili ka të drejtë në arsimim.

Arsimimi është i arritshëm për secilin nën kushte të barabarta.

Arsimimi fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë.

Neni 45

Shtetasit kanë të drejtë, nën kushtet e caktuara me ligj, të themelojnë institucione private të arsimimit në të gjitha shkallët e arsimit, përveçse në arsimin fillor.

Neni 46

Universitetit i garantohet autonomia.

Kushtet për themelimin, ushtrimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së universitetit, rregullohen me ligj.

Neni 47

Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, artistike dhe llojeve të tjera të krijimtarisë.

Garantohen të drejtat të cilat burojnë nga krijimtaria shkencore, artistike dhe nga lloji tjetër i krijimtarisë intelektuale.

Republika nxitë, ndihmon dhe mbron zhvillimin e shkencës, artit dhe kulturës. Republika nxitë dhe ndihmon zhvillimin shkencor dhe teknologjik.

Republika nxitë dhe ndihmon kulturën teknike dhe sportin.

Neni 48⁹

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë lirisht të shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë e komuniteteve të tyre dhe t'i përdorin simbolet e komunitetit të tyre.

Republika ua garanton të gjitha komuniteteve mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore, artistike, arsimore, si dhe shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre.

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë në mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm në mënyrën e caktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër mësohet edhe gjuha maqedonase.

Neni 49¹⁰

Republika kujdeset për pozitën dhe të drejtat e pjesëtarëve të popullit maqedonas në shtetet fqinje dhe për mërgimtarët nga Maqedonia, e ndihmon zhvillimin e tyre kulturor dhe i përparon lidhjet me ta. **Republika në atë rast nuk do të përzihet në të drejtat sovraane të shteteve të tjera dhe në punët e tyre të brendshme.**

Republika kujdeset për të drejtat kulturore, ekonomike dhe sociale të shtetasve të Republikës në botën e jashtme.

3. Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore

Neni 50

Çdo shtetas në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të caktuara me Kushtetutë para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, mund të thirret në procedurën e mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe të urgjencës.

Garantohet mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve individuale të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike.

Shtetasi ka të drejtë të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në mënyrë aktive të kontribuojë, individualisht ose bashkë me të tjerët, për përparimin dhe mbrojtjen e tyre.

Neni 51

Në Republikën e Maqedonisë ligjet duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin.

Secili është i obliguar që të respektojë Kushtetutën dhe ligjet.

Neni 52

Ligjet dhe dispozitat e tjera publikohen para se të hyjnë në fuqi.

Ligjet dhe dispozitat e tjera publikohen në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre.

Ligjet hyjnë në fuqi jo më parë se ditën e tetë nga dita e publikimit e, përjashtimisht, ditën e publikimit, të cilën e cakton Kuvendi.

Ligjet dhe dispozitat e tjera nuk mund të kenë efekt prapaveprues, përveçse përjashtimisht, në rastet kur kjo është më e favorshme për shtetasit.

⁹ Neni 48 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin VIII, pika 1.

¹⁰ Neni 49, paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së është plotësuar me Amendamentin II, pika 1.

Neni 53

Avokatura është shërbim publik i mëvetësishëm dhe i pavarur që siguron ndihmë juridike dhe ushtron autorizime publike në pajtim me ligjin.

Neni 54

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të shtetasit mund të kufizohen vetëm në rastet e caktuara me Kushtetutë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut e të shtetasit mund të kufizohen gjatë kohës së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme sipas dispozitave të Kushtetutës.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, pozitës pasurore ose shoqërore.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk përfshin të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, veprimin dhe dënimin çnjerëzor dhe nënçmues, përcaktueshmërinë juridike të veprave të dënueshme dhe dënimeve, si dhe lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit, shprehjes publike të mendimit dhe të besimit fetar.

4. Bazat e marrëdhënieve ekonomike

Neni 55

Garantohet liria e tregut dhe e ndërmarrësisë.

Republika u siguron pozitë të barabartë juridike të gjitha subjekteve të tregut. Republika ndërmerr masa kundër pozitës monopoliste dhe sjelljes monopoliste në treg.

Liria e tregut dhe e ndërmarrësisë mund të kufizohet me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

Neni 56¹¹

Të gjitha pasuritë natyrore të Republikës, bota bimore dhe shtazore, të mirat në përdorim të përgjithshëm, si dhe sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Republika garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të Maqedonisë dhe të të gjitha komuniteteve në Maqedoni, si dhe të mirave që e përbëjnë atë, pa marrë parasysh regjimin e tyre juridik.

Me ligj rregullohet mënyra dhe kushtet nën të cilat të mirat e caktuara me interes të përgjithshëm për Republikën mund të jepen në shfrytëzim.

Neni 57

Republika nxitë përparimin ekonomik dhe kujdeset për zhvillimin më të harmonizuar hapësinor dhe regjional, si dhe për zhvillimin më të shpejtë të rajoneve ekonomiksht jo mjaft të zhvilluara.

Neni 58

Pronësia dhe puna janë bazë për qeverisje dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

Pjesëmarrja në qeverisje dhe në vendimmarrje në institucionet dhe shërbimet publike rregullohet me ligj dhe në bazë të primeve të profesionalitetit dhe të kompetentësisë.

Neni 59

Investitorëve të huaj u garantohet e drejta e nxjerrjes së lirë të kapitalit të investuar dhe të fitimit.

Të drejtat e fituara në bazë të kapitalit të investuar nuk mund të zvogëlohen me ligj ose me dispozitë tjetër.

¹¹ Neni 56, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin IX, pika 1.

Neni 60

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë është bankë e emisionit.
Banka popullore është e pavarur dhe mban përgjegjësi për stabilitetin e valutës, për politikën monetare dhe për likuiditetin e përgjithshëm të pagesave në Republikë dhe ndaj botës së jashtme.
Organizimi dhe puna e Bankës popullore rregullohen me ligj.

III. ORGANIZIMI I PUSHTETIT SHTETËROR

1. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Neni 61

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është organ përfaqësues i shtetasve dhe bartës i pushtetit ligjvënës i Republikës.
Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit rregullohen me Kushtetutë dhe me Rregulloren e punës.

Neni 62

Kuvendin e përbëjnë 120 deri më 140 deputetë.
Deputetët zgjedhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.
Deputeti i përfaqëson shtetasit dhe në Kuvend vendos sipas bindjes së vet.
Deputeti nuk mund të revokohet.
Mënyra dhe kushtet për zgjedhjen e deputetëve rregullohen me ligj i cili nxirret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 63

Deputetët në Kuvend zgjedhen për katër vjetë. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi.
Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mbledhet në seancën konstitutive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstitutive e konvokon Kryetari i Kuvendit të përbërjes së mëparshme.
Në qoftë se nuk konvokohet seanca konstituive në afatin e parashikuar, deputetët vetë mbledhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetentë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve.
Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditë e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose në afat prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.
Mandati i deputetëve në Kuvend mund të zgjatet vetëm në rast të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.
Me ligj caktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike.
Kuvendi shpërndahet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 64

Deputetët gëzojnë imunitet.
Deputeti nuk mund të thërritet në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votën e dhënë në Kuvend.
Deputeti nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Kuvendit, përveç nëse është zënë në kryerje të veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.
Kuvendi mund të zbatohet imuniteti mbi deputetin edhe kur ai nuk thirret në atë, nëse kjo është e nevojshme me qëllim të ushtrimit të funksionit të deputetit.
Gjatë kohës së mandatit deputetët nuk i nënshtrohen obligimit në forcat e armatosura.
Deputeti ka të drejtë në kompensim të caktuar me ligj.

Neni 65

Deputeti mund të jap dorëheqje.
Deputeti dorëheqjen e paraqet personalisht në seancën e Kuvendit.

Deputetit i ndërpritet mandati kur është dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.

Deputetit mund t'i merret mandati kur është dënuar për vepër penale ose vepër tjetër të dënueshme e cila e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të deputetit, si dhe kur mungon pa arsye për më tepër se gjashtë muaj në Kuvend. Marrjen e mandatit e bën Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 66

Kuvendi është në sesion të përhershëm.

Kuvendi punon në seanca.

Seancat e Kuvendit i konvokon Kryetari i Kuvendit.

Kuvendi nxjerr Rregulloren e punës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Neni 67

Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedhë Kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Kuvendin, kujdeset për zbatimin e Rregullores së punës së Kuvendit dhe ushtron punë të tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Funksioni Kryetar i Kuvendit është i papajtuësëm me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti në politike.

Kryetari i Kuvendit i shpall zgjedhjet për deputetë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës.

Neni 68¹²

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë:

- nxjerr dhe ndryshon Kushtetutën;
- nxjerr ligje dhe bën interpretimin autentik të ligjeve;
- i cakton detyrimet publike;
- nxjerr buxhetin republikan dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- nxjerr planin hapësinor të Republikës;
- ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare;
- vendos për luftën dhe paqen;
- merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës;
- merr vendim për asocim dhe dalje nga bashkimi ose bashkësia me shtetet e tjera;
- shpall referendumin;
- vendos për rezervat e Republikës;
- themelon këshilla;
- zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë;
- zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit;
- jep amnisti dhe
- kryen punë të tjera të caktuara me Kushtetutë.

Kuvendi për kryerjen e punëve nga kompetenca e tij nxjerr edhe vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe konkluzione.

Neni 69¹³

Kuvendi mund të vendos nëse në seancë merr pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, e

¹² Alinea 15 e paragrafit 1 të Nenit 68 të Kushtetutes së RM-së është fshirë me Amendamentin XXIX, pika 2.

¹³ Neni 69 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin X, pika 1 dhe 2.

së paku me shumicën prej një të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë.

Për ligjet të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, me ç'rast duhet të ketë shumicën e votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kontestin në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite e zgjidh Komiteti për marrëdhënie midis komuniteteve.

Neni 70

Seancat e Kuvendit janë publike.

Kuvendi mund të vendos të punojë pa prezencën e publikut me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 71

Të drejtë të propozojë nxjerrjen e ligjit ka çdo deputet i Kuvendit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe së paku 10.000 zgjedhës.

Inisiativë për nxjerrjen e ligjit propozuesit të autorizuar mund t'i bëj çdo shtetas, grup i shtetasve, çdo institucion dhe shoqatë.

Neni 72

Interpelancë mund të shtrohet për punën e secilit bartës të funksionit publik, Qeverisë dhe secilit anëtar të saj veç e veç, si dhe për çështjet nga puna e organeve shtetërore.

Interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë.

Pyetje deputeti mund të shtrojë çdo deputetë.

Mënyra dhe procedura e paraqitjes dhe e diskutimit lidhur me interpelancën dhe pyetjen e deputetit rregullohen me Rregulloren e punës.

Neni 73

Kuvendi vendosë për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e tij me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi në referendum është miratuar, nëse për të ka votuar shumica e zgjedhësve të cilët kanë votuar, me kusht që në referendum të ketë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Kuvendi është i obliguar që të shpall referendumin kur propozimin do të paraqesin së paku 150.000 zgjedhës.

Vendimi i miratuar në referendum është i obligueshëm.

Neni 74

Kuvendi merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi për ndryshimin e kufirit të Republikës është miratuar në referendum, në qoftë se për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Neni 75

Ligjet shpallen me dekret.

Dekretin për shpalljen e ligjeve e nënshkruajnë Kryetari i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit.

Kryetari i Republikës mund të vendos të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Kuvendi sërish e shqyrton ligjin dhe në qoftë se e miraton me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Kryetari i Republikës është i obliguar që ta nënshkruajë dekretin.

Kryetari është i obliguar ta nënshkruajë dekretin, në qoftë se sipas Kushtetutës, ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 76

Kuvendi themelon trupa punues të përhershëm dhe të përkohshëm.
Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese për të gjithë lëmenjtë dhe për çdo çështje me interes publik.

Propozim për themelimin e komisionit anketues mund të paraqesin së paku 20 deputetë.

Kuvendi themelon komision të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të shtetasit.

Të dhënat e komisioneve anketuese janë bazë për iniciimin e procedurës për caktimin e përgjegjësive të bartësve të funksioneve publike.

Neni 77¹⁴

Kuvendi zgjedhë avokatin e popullit me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Avokati i popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të shtetasve të cilat u janë shkelur nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat e tjera që kanë autorizime publike. **Avokati i popullit i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit, të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjestarëve të komuniteteve në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisve të vetadministrimit lokal dhe në institucionet dhe shërbimet publike.**

Avokati i popullit zgjedhet për kohën prej tetë vjetësh, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet për zgjedhjen dhe shkarkimin, kompetencat dhe mënyra e punës së avokatit të popullit rregullohen me ligj.

Neni 78¹⁵

Kuvendi themelon Komitetin për marrëdhënie midis komuniteteve.

Komitetin e përbëjnë 19 anëtarë prej të cilëve nga shtatë anëtarë nga radha e deputetëve maqedonas dhe shqiptarë të Kuvendit dhe nga një anëtarë nga radha e deputetëve turq, vllah, rom, serb dhe boshnjak. Në qoftë se ndonjë nga komunitetet nuk ka deputet, avokati i popullit, pas konsultimeve me përfaqësuesit relevant të atyre komuniteteve, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit.

Kuvendi i zgjedhë anëtarët e Komitetit.

Komiteti shqyrton çështjet nga marrëdhëniet midis komuniteteve në Republikë dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre.

Kuvendi është i obliguar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të merr vendime lidhur me to.

Në rast të kontestit lidhur me zbatimin e procedurës për votim në Kuvend, të caktuar me nenin 69 paragrafi 2, Komiteti vendos, me shumicën e votave të anëtarëve, për atë se a do të zbatohet procedura.

2. Kryetari i Republikës së Maqedonisë

Neni 79

Kryetari i Republikës së Maqedonisë e përfaqëson Republikën.

Kryetari i Republikës është komandant suprem i forcave të armatosura të Maqedonisë.

Kryetari i Republikës të drejtat dhe detyrat e veta i ushtron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 80

¹⁴ Neni 77, paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XI, pika 1, ndërsa paragrafi 2 i Nenit 77, është plotësuar me Amendamentin XI, pika 2.

¹⁵ Neni 78 i Kushtetutës së RM-së, është zëvendësuar me Amendamentin XII, pika 1.

Kryetari i Republikës zgjedhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, për kohën prej pesë vjetësh.

Për Kryetar të Republikës personi i njëjtë mund të zgjedhet më së shumti dy herë.

Kryetari i Republikës duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Për Kryetar të Republikës nuk mund të zgjedhet personi i cili deri në ditën e zgjedhjeve nuk ka qenë banor i Republikës së Maqedonisë së paku dhjetë vjet në 15 vjetët e fundit.

Neni 81

Kandidat për Kryetar të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë.

Për Kryetar të Republikës është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Nëse në rrethin e parë asnjë kandidat për Kryetar nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar më së shumti vota.

Rrethi i dytë i votimit mbahet në afat prej 14 ditësh nga mbarimi i rrethit të parë të votimit.

Për Kryetar është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve.

Në qoftë se edhe në rrethin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Nëse për Kryetar të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në rrethin e parë të votimit nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Zgjedhja e Kryetarit të Republikës bëhet në 60 ditët e fundit të mandatit të Kryetarit të mëparshëm. Në rast të ndërprerjes të mandatit të Kryetarit të Republikës nga cilatdo shkaqe, zgjedhja e Kryetarit bëhet në afat prej 40 ditësh nga dita e ndërprerjes së mandatit.

Para marrjes së detyrës, Kryetari i Republikës bën deklaratë solemne para Kuvendit me të cilën obligohet në respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 82

Në rast të vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë së përhershme që ta ushtrojë funksionin ose ndërprerjes së mandatit sipas fuqisë së Kushtetutës, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Republikës, funksionin e Kryetarit të Republikës e ushtron Kryetari i Kuvendit.

Ekzistimin e kushteve për ndërprerjen e funksionit të Kryetarit të Republikës e vërteton Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë sipas detyrës zyrtare.

Në rast të pamundësisë që ta ushtrojë funksionin, Kryetarin e Republikës e zëvendëson Kryetari i Kuvendit.

Kur Kryetari i Kuvendit e ushtron funksionin e Kryetarit të Republikës, ai merr pjesë në punën e Kuvendit pa të drejtë vendosjeje.

Neni 83

Detyra e Kryetarit të Republikës është e papajtueshme me ushtrimin e tjetër funksioni, profesioni publik ose funksionit në parti të politike.

Kryetari i Republikës gëzon imunitet.

Për marrjen e imunitetit Kryetarit të Republikës vendos Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Neni 84¹⁶

Kryetari i Republikës së Maqedonisë:

- cakton mandatarin për formimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë;
- emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë në botën e jashtme;

¹⁶ Neni 84, alinea 7 e Kushtetutës së RM-së është fshirë me Amendamentin XII, pika 1, ndërsa alinea 5 e Neni 84 është zëvendësuar me Amendamentin XXII, pika 1.

- pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatik;
- propozon dy gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- **propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;**
- emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë;
- emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- jep dekorata dhe mirënjohje në pajtim me ligjin;
- bën faljen në pajtim me ligjin dhe
- kryen detyra të tjera të caktuara me Kushtetutë.

Neni 85

Kryetari i Republikës i raporton Kuvendit për çështjet nga kompetenca e vet së paku një herë në vit.

Kuvendi mund të kërkojë nga Kryetari i Republikës mendim për çështjet nga kompetenca e tijë.

Neni 86¹⁷

Kryetari Republikës është Kryetari i Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë.

Këshillin për Siguri të Republikës e përbëjnë: Kryetari i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, ministrat të cilët udhëheqin organet e administratës shtetërore në lëmenjtë e sigurimit, mbrojtjes dhe të punëve të jashtme dhe tre anëtarë të cilët i emëron Kryetari i Republikës. **Me rastin e emërimit të tre anëtarëve, Kryetari do të sigurojë përbërjen e Këshillit që, si tërësi, në mënyrë adekuate ta shpreh përbërjen e popullsisë në Republikën e Maqedonisë.**

Këshilli shqyrton çështje lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës dhe i jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë.

Neni 87

Kryetari i Republikës mban përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe të ligjeve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të veta.

Procedurën për vërtetimin e përgjegjësisë të Kryetarit të Republikës e ngre Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e Kryetarit vendos Gjykata Kushtetuese me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Nëse Gjykata Kushtetuese e vërteton përgjegjësinë e Kryetarit të Republikës, funksioni i ndërpritet sipas fuqisë së Kushtetutës.

3. Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Neni 88

Qeveria e Republikës së Maqedonisë është bartëse e pushtetit ekzekutiv.

Të drejtat dhe detyrat e veta Qeveria i ushtron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 89¹⁸

Qeverinë e përbëjnë Kryetari dhe ministrat.

Kryetari dhe ministrat nuk mund të jenë deputetë në Kuvend.

Kryetari gëzon imunitet. Për imunitetin e tij vendos Kuvendi.

Kryetari dhe ministrat nuk i nënshtrohen obligimit në forcat e armatosura.

Funksioni Kryetar i Qeverisë dhe ministër është i papajtueshëm me ushtrimin e të tjera funksioneve ose profesioneve publike.

Organizimi dhe mënyra e punës së Qeverisë rregullohet me ligj.

¹⁷ Neni 86, paragrafi 2 i Kushtetutes së RM-së është plotësuar me Amendamentin XIII, pika 1.

¹⁸ Neni 89, paragrafi 3 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXIII, pika 1.

Neni 90

Kryetari i Republikës së Maqedonisë është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e konstitutimit të Kuvendit mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besoj kandidatit të partisë, përkatësisht të partive që kanë shumicë në Kuvend.

Mandatari, në afat prej 20 ditësh nga dita e besimit të mandatis, Kuvendit ia paraqet programin dhe i propozon përbërjen e Qeverisë.

Qeverinë, me propozimin e mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedhë Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 91¹⁹

Qeveria e Republikës së Maqedonisë:

- cakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të tjera të Kuvendit dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tyre;
- propozon ligje, buxhetin republikan dhe dispozita të tjera të cilat i nxjerr Kuvendi;
- propozon planin hapësinor të Republikës;
- propozon vendime për rezervat e Republikës dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- nxjerr dekrete ligje dhe dispozita të tjera për zbatimin e ligjeve;
- cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe ushtron mbikëqyrje mbi punën e tyre;
- jep mendime për propozim ligjet dhe dispozitat e tjera të cilat Kuvendit ia paraqesin propozuesit e tjerë të autorizuar;
- vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive;
- vendos marrëdhënie diplomatike dhe konsulare me shtetet e tjera;
- merr vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike-konsulare në botën e jashtme;
- propozon emërimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesëve të Republikës së Maqedonisë në botën e jashtme dhe emëron shefat e përfaqësive konsulare;
- **propozon Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë pas mendimit paraprak të Këshillit të Prokurorëve Publik;**
- bën emërimin dhe shkarkimin e bartësve të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj dhe
- kryen punë të tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 92

Qeveria dhe çdo anëtar i saj, për punën e vetë përgjigjen para Kuvendit.

Kuvendi mund t'i votoj mosbesimin Qeverisë.

Mocionin e besimit Qeverisë mund ta shtojnë së paku 20 deputetë.

Votimi për mocionin e besimit Qeverisë bëhet pas kalimit të tri ditëve prej ngritjes së mocionit të besimit.

Mocioni i besimit Qeverisë nuk mund të shtrohet para kalimit të 90 ditëve prej votimit të fundit për besim, përveç nëse çështjen e mocionit të besimit e shtron shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimi për votimin e mosbesimit të Qeverisë merret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Nëse Qeverisë i është votuar mosbesimi, Qeveria është e obliguar të jap dorëheqje.

Neni 93

Qeveria ka të drejtë të shtrojë çështjen e besimit para Kuvendit.

Qeveria ka të drejtë të jap dorëheqje.

Dorëheqja e Kryetarit të Qeverisë, vdekja ose pamundësia e përhershme e tij që ta ushtrojë funksionin, tërheqin dorëheqjen e Qeverisë.

Qeverisë i pushon mandati kur shpërndalet Kuvendi.

Qeverisë të cilës i është votuar mosbesimi, e cila ka dhënë dorëheqje ose të cilës i pushon mandati për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

¹⁹ Neni 91, alinea e 12 e Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXIV, pika 1.

Neni 94

Anëtari i Qeverisë ka të drejtë të jap dorëheqje.

Kryetari i Qeverisë mund të propozoj shkarkimin e anëtarit të Qeverisë.

Për propozimin për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë vendos Kuvendi në seancën e parë të ardhshme.

Në qoftë se Kryetari i Qeverisë propozon shkarkimin e më shumë se një të tretës të anëtarëve të Qeverisë të përbërjes fillestare, Kuvendi vendos si për zgjedhjen e Qeverisë së re.

Neni 95

Administratën shtetërore e përbëjnë ministrinë dhe organet e tjera të administratës dhe organizatat e caktuara me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në organet e administratës shtetërore.

Organizimi dhe puna e organeve të administratës shtetërore rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 96

Organet e administratës shtetërore punët nga kompetenca e tyre i ushtrojnë në mënyrë të pavarur në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve dhe për punën e tyre i përgjegjen Qeverisë.

Neni 97

Organet e administratës shtetërore në lëmenjtë e mbrojtjes dhe policisë i udhëheqin personat civil të cilët drejtpërdrejtë para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civil së paku tre vite.

4. Gjyqësia

Neni 98²⁰

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat.

Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

Janë të ndaluara gjykatat e jashtëzakonshme.

Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 99²¹

Gjyqtari zgjedhet pa kufizim kohor të mandatit.

Gjyqtari nuk mund të transferohet kundër vullnetit të tij.

Gjyqtarit i ndërpritet funksioni i gjyqtarit:

- nëse atë e kërkon vetë;
- nëse e humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, të cilën e vërteton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë;
- nëse i plotëson kushtet për pension të pleqërisë;
- nëse është dënuar me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor për veprë penale me dënim të pakusht me burg prej së paku 6 muaj dhe
- nëse është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik, përveçse kur funksioni i gjyqtarit pushon nën kushtet e caktuara me ligj.

Gjyqtari shkarkohet:

- për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të paraparë me ligj dhe

²⁰ Neni 98 i Kushtetutës së RM-së, është zëvendësuar me Amendamentin XXV, pika 1.

²¹ Neni 99, paragrafi 3 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXVI, pika 1.

- për shkak të ushtrimit jo profesional dhe jo të ndërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit nën kushtet e caktuara me ligj.

Neni 100²²

Gjyqtarët gëzojnë imunitet.

Gjyqtari nuk mund të merret në përgjegjësi penale për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Gjyqtari nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse është zënë në kryerje të veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.

Funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me anëtarësinë në parti politike ose me ushtrimin e tjetër funksioni ose profesioni publik të caktuar me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në gjyqësi.

Neni 101

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është gjykata më e lartë në Republikë dhe siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Neni 102

Shqyrtimi para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit janë publike.
Opinionin mund të përjashtohet në rastet e caktuara me ligj.

Neni 103

Gjykata gjykon në kolegji.

Me ligj caktohet kur gjyqtari gjykon si gjyqtar i vetëm.

Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarët porotë kur ajo është caktuar me ligj.

Gjyqtarët porotë nuk mund të merren në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore.

Neni 104²³

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i gjyqësisë. Këshilli e siguron dhe e garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Këshillin e përbëjnë pesëmbëdhjetë anëtarë.

Sipas funksionit anëtarë të Këshillit janë Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministri i Drejtësisë.

Tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e veta. Tre nga anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i shtetasve të cilët u takojnë të gjitha komuniteteve.

Tre anëtarë të Këshillit i zgjedhë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Dy anëtarë të Këshillit i propozon Kryetari i Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjen e bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve njëri është pjesëtar i komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Anëtarët e Këshillit që i zgjedhë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht që i propozon Kryetari i Republikës së Maqedonisë janë nga radha e profesorëve universitar të drejtësisë, avokatëve dhe juristëve të tjerë të dalluar.

²² Neni 100, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXVII, pika 1, ndërsa me Amendamentit XVII, pika 2, është zëvendësuar paragrafi 3 i Neni 100.

²³ Neni 104 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXVIII, pika 1.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit zgjat gjashtë vjet, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet dhe procedura për zgjedhjen, si dhe bazat dhe procedura për ndërprerjen e funksionit dhe shkarkimit të anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Funksioni anëtarë i zgjedhur i Këshillit është i papajtueshëm me anëtarësinë në parti politike ose me ushtrimin e tjera funksioneve dhe profesioneve publike të caktuara me ligj.

Neni 105²⁴

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë:

- zgjedh dhe shkarkon gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë;
- vërteton ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarët e gjykatave;
- përcjellë dhe vlerëson punën e gjyqtarëve;
- vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve;
- vendos për marrjen e imunitetit të gjyqtarëve;
- propozon dy gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve dhe
- kryen punë të tjera të caktuara me ligj.

Me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve, gjyqtarëve porot dhe kryetarëve të gjykatave do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i shtetasve të cilët u takojnë të gjitha komuniteteve.

Këshilli për punën e tij i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, forma, përmbajtja dhe mënyra e miratimit të të cilit rregullohen me ligj.

5. Prokuroria Publike

Neni 106²⁵

Prokuroria Publike është organ unik dhe i mëvetësishëm shtetëror i cili i ndjekë kryerësit e veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme të caktuara me ligj dhe ushtron edhe punë të tjera të caktuara me ligj.

Prokuroria Publike i ushtron funksionet e saj në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

Funksionin e prokurorisë publike e ushtrojnë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publik.

Kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe funksionimi i prokurorisë publike rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë e zgjedhë dhe e shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për kohën prej gjashtë vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.

Prokurorët publik i zgjedhë Këshilli i Prokurorëve Publik pa kufizim kohor të mandatit.

Me rastin e zgjedhjes të prokurorëve publik do të respektohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i shtetasve të cilët u takojnë të gjitha komuniteteve.

Për shkarkimin e prokurorëve publik vendos Këshilli.

Kompetencat, përbërja dhe struktura e Këshillit, mandati i anëtarëve të tij, si dhe bazat dhe procedura për ndërprerjen dhe shkarkimin e anëtarit të Këshillit rregullohen me ligj.

Bazat dhe procedura për ndërprerjen dhe shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë dhe të prokurorëve publik rregullohen me ligj.

Funksioni Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokuror publik është i papajtueshëm me anëtarësinë në parti politike ose me ushtrimin e tjera funksioneve dhe profesioneve publike të caktuara me ligj.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në Prokurorinë publike.

IV. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

²⁴ Neni 105 i Kushtetutës së RM-së, është zëvendësuar me Amendamentin XXIX, pika 1.

²⁵ Neni 106, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XXX dhe njëherazi me këtë amendament është fshirë neni 107.

Neni 108

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë është organ i Republikës e cila mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Neni 109²⁶

Gjykatën Kushtetuese e përbëjnë nëntë gjyqtar.

Kuvendi i zgjedhë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i zgjedhë gjashtë gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi i zgjedhë tre gjyqtarë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë edhe shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjykata Kushtetuese zgjedhë nga radhët e veta kryetarin me mandat prej tre vjetësh dhe pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjedhen nga radha e juristëve të dalluar.

Neni 110

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë:

- vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- vendos për pajtueshmërinë e dispozitave të tjera dhe të kontratave kolektive me Kushtetutën dhe me ligjet;
- i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut e të shtetasit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe me ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike;
- vendos për konfliktin për kompetencë midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- vendos për konfliktin për kompetencë midis organeve të Republikës dhe njërive të vetadministrimit lokal;
- vendos për përgjegjësinë e Kryetarit të Republikës;
- vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile dhe
- vendos edhe për çështje të tjera të caktuara me Kushtetutë.

Neni 111

Funksioni gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese është i papajtueshëm me ushtrimin e tjetër funksioni dhe profesioni publik ose me anëtarësinë në parti politike.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet. Për imunitetin e tyre vendos Gjykata Kushtetuese.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk i nënshtrohen obligimit në forcat armatosura.

Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese funksioni i ndërpritet nëse paraqet dorëheqje. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese do të shkarkohet nga detyra nëse dënohet për vepër penale me dënim me burg të pakusht prej së paku gjashtë muajsh ose kur do të humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të tij, të cilën e vërteton Gjykata Kushtetuese.

Neni 112

Gjykata Kushtetuese do ta shfuqizojë ose anulojë ligjin nëse vërteton se nuk është në pajtim me Kushtetutën.

²⁶ Neni 109, paragrafi 3 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XV, pika 1.

Gjykata Kushtetuese do ta shfuqizojë ose anulojë dispozitën tjetër ose aktin e përgjithshëm, kontratën kolektive, statutin ose programin e partisë politike ose të shoqatës, nëse vërteton se ata nuk janë në pajtim me Kushtetutën ose me ligjin.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme.

Neni 113

Mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me aktin e Gjykatës.

V. VETADMINISTRIMI LOKAL

Neni 114²⁷

Shtetasve u garantohet e drejta e vetadministrimit lokal.

Njësitë e vetadministrimit lokal janë komunat.

Në komuna mund të themelohen forma të vetadministrimit vendor.

Komunat finansohen nga burimet vetanake të të hyrave të përcaktuara me ligj dhe me mjete nga Republika.

Vetadministrimi lokal rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet medoemos të ketë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Ligjet për finansimin lokal, zgjedhjet lokale, kufijtë komunal dhe për qytetin e Shkupit, nxirren me shumicën e votave nga deputetët e pranishëm, me ç'rast duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve të pranishëm të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 115²⁸

Në njësitë e vetadministrimit lokal shtetasit drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet të përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale, e veçanërisht në lëmenjtë e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, finansimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në lëmenjtë e tjerë të caktuar me ligj.

Komuna është e pavarur në ushtrimin e kompetencave të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndërsa mbikqyrjen e ligjshmërisë mbi punën e saj e bën Republika.

Republika me ligj mund t'ia besojë komunës kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 116

Ndarja territoriale e Republikës dhe territori i komunave caktohen me ligj.

Neni 117²⁹

Qyteti i Shkupit është njësi e veçantë e vetadministrimit lokal, organizimi i të cilit rregullohet me ligj.

Në qytetin e Shkupit shtetasit drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrje për çështjet me rëndësi lokale, e veçanërisht në lëmenjtë e shërbimeve publike, urbanizmit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit ekonomik lokal, finansimit lokal, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetësore dhe në lëmenjtë e tjerë të caktuar me ligj.

Qyteti i Shkupit finansohet nga burimet vetanake të të hyrave të përcaktuara me ligj dhe me mjete nga Republika.

Qyteti i Shkupit është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndërsa mbikqyrjen e ligjshmërisë mbi punën e tij e bën Republika.

Republika me ligj mund t'ia besojë qytetit të Shkupit kryerjen e punëve të caktuara.

²⁷ Neni 114, paragrafi 5 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVI, pika 1.

²⁸ Neni 115, paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 1.

²⁹ Neni 117, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 2.

VI. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Neni 118

Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj.

Neni 119

Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë i lidh Kryetari i Republikës së Maqedonisë.

Marrëveshje ndërkombëtare mund të lidh edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kur ajo është përcaktuar me ligj.

Neni 120

Propozim për asocim në bashkime ose në bashkësi me shtetet e tjera ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera mund të paraqes Kryetari i Republikës, Qeveria ose së paku 40 deputetë.

Vendimin për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimin për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera është miratuar, nëse në referendum për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve.

Neni 121

Vendim për asocim në anëtarësi ose për dalje nga anëtarësia në organizatat ndërkombëtare merr Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 40 deputetëve.

VII. MBROJTJA E REPUBLIKËS, GJENDJA E LUFTËS JASHTËZAKONSHME

DHE GJENDJA E

Neni 122

Forcat e armatosura të Republikës së Maqedonisë e mbrojnë integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës.

Mbrojtja e Republikës rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 123

Askush nuk ka të drejtë të pranojë okupimin e Republikës së Maqedonisë ose të ndonjë pjese të saj.

Neni 124

Gjendja e luftës fillon kur paraqitet rreziku i drejtpërdrejtë i luftës nga sulmi ndaj Republikës ose kur Republika është sulmuar ose i është shpallur luftë.

Gjendje lufte shpall Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 30 deputetëve.

Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e merr kryetari i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për miratim porsa ai të ketë mundësi të mblidhet.

Neni 125

Gjendja e jashtëzakonshme paraqitet kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi.

Ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Republikës së Maqedonisë ose të një pjese të saj e cakton Kuvendi në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 30 deputetëve.

Vendimin me të cilin caktohet ekzistimi i gjendjes së jashtëzakonshme merret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe vlen më së shumti 30 ditë.

Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme e merr Kryetari i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për miratim porsa ai të ketë mundësi të mblidhet.

Neni 126

Me rastin e ekzistimit të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme Qeveria në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin nxjerrë dekrete me fuqi ligjore.

Autorizimi i Qeverisë që të nxjerrë dekrete me fuqi ligjore zgjat deri në përfundimin e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, për të cilën vendos Kuvendi.

Neni 127

Në kohën e gjendjes së luftës, nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, Kryetari i Republikës mund ta emërojë dhe shkarkojë Qeverinë dhe të emërojë dhe shkarkojë funksionarë zgjedhja e të cilëve është në kompetencën e Kuvendit.

Neni 128

Mandati i Kryetarit të Republikës, Qeverisë, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës vazhdohet për kohën e zgjatjes së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

VIII. NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Neni 129

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ndryshohet dhe plotësohet me amendamente kushtetuese.

Neni 130

Propozim për t'i hyrë ndryshimit të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë mund të paraqesin Kryetari i Republikës, Qeveria, së paku 30 deputetë ose 150.000 shtetas.

Neni 131³⁰

Vendim për t'i hyrë ndryshimit të Kushtetutës merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Projektin për ndryshimin e Kushtetutës e përcakton Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe e vë në diskutim publik.

Vendim për ndryshimin e Kushtetutës merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Vendimin për ndryshimin e Preambulës, neneve për vetadministrim lokal, nenit 131, cilësdo dispozitë që ka të bëjë me të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve, përfshirë veçanërisht nenet 7, 8, 9, 19, 48, 56, 69, 77, 78, 86, 104 dhe 109, si dhe vendimin për shtimin e çfarëdo dispozite të re që ka të bëjë me përmbajtjen e atyre dispozitave dhe neneve, do të jetë e nevojshme shumica prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, në të cilën duhet të ketë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Ndryshimin e Kushtetutës e shpall Kuvendi.

³⁰ Neni 131 i Kushtetutës së RM-së është plotësuar me Amendamentin XVIII, pika 1.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 132

Në kohën e parashikuar në paragrafin 5 të nenit 80 të kësaj Kushtetute llogaritet edhe koha e banimit në republikat e tjera të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 133

Për zbatimin e Kushtetutës do të nxirret ligji kushtetues.

Ligji kushtetues nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri përgjithshëm i deputetëve.

Ligjin kushtetues e shpall Kuvendi dhe hyn në fuqi njëkohësisht me shpalljen e Kushtetutës.

Neni 134

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.